

SKEMA E GRANTEVE NË PAJISJE DHE MAKINERI PËR BIZNESET RURALE DHE FERMERËT NË BASHKINË E TIRANËS



Thirrja e parë për aplikime
01 Mars 2024 - 29 Mars 2024



UDHËZUESI PËR APLIKANTËT

I. HYRJE

Bashkia Tiranë dhe HELP-Hilfe zur Selbsthilfe e.V. dega Shqipëri (Help) nënshkruan marrëveshjen e bashkëpunimit për përkrahjen e të paktën 40 fermerëve dhe bizneseve rurale me grante deri në 2,500 Euro për blerjen e pajisjeve/makinerive përgjatë vitit 2024.

Skema e granteve zbatohet nga Help në kuadër të projektit “Përfshirja dhe Fuqizimi Ekonomik në Ballkanin Perëndimor”, financuar nga Zyra e Jashtme Federale e Gjermanisë (GFFO) dhe Aktion Deutschland Hilft (ADH) dhe bashkëfinancuar nga Bashkia Tiranë. Ky projekt synon të kontribuojë në gjithëpërfshirjen sociale të grupeve të cënueshme dhe të përmirësojë qëndrueshmërinë ekonomike të bizneseve rurale dhe fermave të vogla në Bashkinë e Tiranës.

Ky udhëzues do t’ju vijë në ndihmë të gjithë individëve që kanë një biznes të vogël rural, duan të hapin një të tillë apo për fermerët që kanë nevojë për përkrahje në formën e pajisjeve dhe makinerive duke qartësuar procedurat dhe mënyrën e aplikimit.

II. OBJEKTIVI I THIRRJES

Qëllimi i kësaj thirrjeje është të mbështesë në mënyrë të drejtëpërdrejtë përmes skemës së granteve për pajisje dhe makineri për bizneset rurale dhe fermerët për të gjithë ata individë dhe veçanërisht për të gjithë ata të rinj dhe të reja që duan të investojnë apo të kontribuojnë në zhvillimin e sektorit të bujqësisë dhe turizmit, manifakturës dhe prodhimeve organike.

III. PËRKUFIZIMET

- **Aplikuesi:** është person fizik ose juridik i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB), apo individi i pajisur me Kartën e Fermerit që paraqet një kërkesë për ndihmë në bazë të Thirrjes për Aplikime. Aplikues mund të jetë edhe një individ që ende nuk është regjistruar si person fizik, juridik apo me kartë fermeri, megjithatë këta aplikantë duhet të regjistrohen në një nga format e lartpërmendura nëse shpallen fitues, para përfitimit të grantit dhe nënshkrimit të kontratës. **Nëse regjistrimi nuk ndodh, granti për ta anulohet.**
- **Përfituesi (ose përfituesi i grantit):** është një person fizik ose juridik i regjistruar në QKB, apo individi i pajisur me Kartën e Fermerit që përfiton ndihmë nga skema granteve për pajisje dhe makineri për bizneset rurale dhe fermerët;
- **Ndihma:** është mbështetja me pajisje dhe makineri për bizneset rurale dhe fermerët të shpallura fituese pas finalizimit të procesit të përzgjedhjes;
- **Vendimi për dhënien e granteve:** është një vendim i Help për të dhënë Kontratën e Grantit për aplikuesit e suksesshëm duke finalizuar procesin e përzgjedhjes;
- **Kontrata e dhënies së Grantit:** është dokumenti ligjor në bazë të të cilit përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e Help dhe përfituesit të grantit.

IV. SHUMA E GRANTIT

Përmes kësaj thirrjeje do të përkrahen të paktën 40 fermerë dhe biznese rurale (përfshirë start-up-e, biznese agroturistike, apo të regjistruar me NIPT fermeri). Ata përfitojnë një grant për krijimin ose zhvillimin e një biznesi në formën e makinerive dhe pajisjeve në shumën deri në **2'500 Euro**.

Skema e granteve të vogla parashikon, që aplikanti duhet të ofrojë **kontribut financiar të barasvlershëm me të paktën 20% të financimit të kërkuar në grant.**

Aplikantët e përzgjedhur mund të planifikojnë për financim shtesë duke përdorur instrumente të tjera financiare (kredi, hua, grante, etj.) të disponueshme në Shqipëri nëpërmjet institucioneve financiare ose me financat e tyre. Nëse instrumenti financiar do të përdoret së bashku me grantin për fillimin e planit të biznesit, atëherë ky burim financimi duhet të përfshihet në planin e biznesit dhe do të jetë subjekt i vlerësimit.

Granti i dhënë aplikantit nga ana e Help-it nuk duhet të përdoret si kolateral nëse aplikanti aplikon për kredi në institucionet financiare.

V. APLIKANTËT E PRANUESHËM

Grantet të cilat do të ofrohen do të jenë në zonat rurale në Bashkinë e Tiranës, dhe si të tilla pritet që për të qënë të pranueshëm jo vetëm që aplikantët **duhet të jenë banorë të Bashkisë së Tiranës** por që edhe **aktivitetin e tyre të biznesit ta ushtrojnë në Bashkinë e Tiranës** në të paktën një nga sektorët e mëposhtëm:

- Bizneset e vogla dhe të mesme rurale në tërësi;
- Fermat;
- Bizneset e vogla dhe të mesme agroturistike në veçanti.

Prioritet do u jepet aplikantëve:

- të rinjve dhe grave
- me ide biznesi unike (jo të përsëritura ndërmjet aplikantëve) ose që ofrojnë produkte apo shërbime të reja,
- me biznese që nxitin zhvillimin rural (por jo vetëm) të zonës;
- që përdorin zgjidhje teknike dhe teknologji prodhimi të reja dhe/ose që kursejnë energji;
- që përdorin burime të energjisë së rinovueshme; dhe
- me biznese që krijojnë më shumë mundësi punësimi.

Pavarësisht sektorit të zgjedhur, idetë e mëposhtme të biznesit nuk janë të pranueshme për të qënë pjesë e mbështetjes nga kjo skemë granti:

- ide/biznese që bien ndesh me kuadrin kushtetues dhe ligjor të Republikës së Shqipërisë;

- ide që kërkojnë pajisje që nuk janë në përputhje me veprimtarinë e biznesit;
- shërbime të pasurive të patundshme, qiraja për pasuri të tundshme;
- prodhim duke përdorur teknologji që shkakton ndotje mjedisore (siç është ndotja e ajrit, ujit, tokës, etj.);
- ose çfarëdolloj aktiviteti i cili ndikon negativisht në shëndet, mjedis dhe ka impakt negativ në zonë.

VI. APLIKANTËT JO TË PRANUESHËM

Aplikuesi/ja do të përjashtohet nga pjesëmarrja e mëtejshme në qoftë se:

- Nuk ka dokument të vlefshëm identifikues të Republikës së Shqipërisë;
- Nuk është banor/e i njërës prej njësive administrative të Bashkisë Tiranë;
- Dorëzon aplikimin pas afatit zyrtar të dorëzimit të aplikimeve;
- Është punonjës i administratës publike apo familjar i tyre;
- Dorëzon më shumë se një aplikim;
- Në mënyrë direkte apo indirekte ofron, premtan, jep apo kërkon rryshfet për përfitime të tjera, me qëllim krijimin apo zhvillimin e biznesit.

VII. PAJISJET DHE MAKINERITË E PRANUESHME

7.1 Pajisjet dhe makineritë e pranueshme

Pajisjet dhe makineritë e pranueshme që mund të mbulohen nga granti duhet të përdoren për zbatimin e planit të biznesit dhe mund të përfshijnë:

- pajisje për mobilim ose materiale për rregullim të mjediseve/godinave për biznesin;
- blerjen e makinerive, mjeteve dhe pajisjeve, si edhe software dhe asete të tjera jo të prekshme;
- etj.

Të gjitha pajisjet dhe makineritë e blera duhet të jenë të reja.

Të gjitha pajisjet dhe makineritë duhet të blihen brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

Pajisjet dhe makineritë jo të pranueshme

Pajisjet dhe makineritë jo të pranueshme që nuk mund të mbulohen nga granti përfshijnë:

- gjë e gjallë (bagëti të imta, bletë, etj.);

- materiale të papërpunuara dhe produkte të konsumueshme;
- mjete të transportit që nuk do të përdoren direkt për funksionimin e biznesit të propozuar;
- çdo pajisje apo makineri që nuk lidhet me biznesin e propozuar.

Pajisjet dhe makineritë jo të pranueshme në grant mund të mbulohen nëpërmjet kontributit personal të aplikantit, dhe formave të tjera të financimit, siç janë kreditë, huaja, etj.

VIII. PROCEDURA E APLIKIMIT

8.1 Përmbajtja e aplikimit

- Aplikantët duhet të dorëzojnë Formularin e Aplikimit të plotësuar dhe dokumentet mbështetëse të listuar në Formularin e Aplikimit për këtë thirrje.
- Aplikantët duhet të aplikojnë në gjuhën shqipe.
- Aplikimet duhet të paraqiten të shtypura në kompjuter ose me shkrim dore me kushtin që ky i fundit të jetë lehtësisht i lexueshëm. Për këtë të fundit sugjerohet të përdoren shkronja të mëdha shtypi. **Aplikimet, teksti i të cilave është shkruar me shkrim dore të palexueshme do të refuzohen.**
- Aplikantët duhet të dorëzojnë **Formularin e Aplikimit** duke përdorur modelin e dhënë. Formulari i aplikimit duhet të plotësohet në çdo seksion dhe dorëzohet në origjinal, i printuar dhe firmosur.
- **Aplikimet duhet të shoqërohen me dokumente mbështetëse**, për verifikimin e së drejtës së aplikuesit, investimet dhe shpenzimet. Dokumentet mbështetëse të kërkuara duhet të jepen në origjinal ose në formën e fotokopjeve. Duhet të dorëzohen dokumentet mbështetëse të mëposhtme:
 - a) Kopje e kartës së identitetit apo pasaportë e aplikantit,
 - b) Kopje e çertifikatës familjare (e gjeneruar nga e-albania),
 - c) Kopje e çertifikatës së regjistrimit të biznesit (NIPT) së bashku me ekstraktin historik, apo të Kartës së fermerit (NIF),
 - d) Licensat për zhvillimin e aktivitetit (nëse ka),
 - e) Diplomat/çertifikatat (nëse janë të ndërlidhura me veprimtarinë për të cilën aplikohet),
 - f) Dokumente të tjera mund të ju kërkohen sipas rastit, gjatë fazës së vlerësimit dhe përzgjedhjes për të verifikuar të dhënat e deklaruara në formularin e aplikimit.

8.2 Dorëzimi i aplikimeve

Help do refuzojë të gjitha aplikimet që janë dorëzuar para publikimit të Thirrjes për Dorëzimin e Aplikimeve.

Aplikimet duhet të dorëzohen në zarfe të mbyllura. Në pjesën e pasme të zarfit detyrimisht shkruani emrin dhe mbiemrin tuaj dhe adresën tuaj të saktë. Në pjesën e parme të zarfit shënoni adresën e zyrës së organizatës Help Shqipëri, me titullin Thirrje për Dorëzimin e Aplikimeve, së bashku me titullin e skemës së granteve të vogla, dhe me shënimin “Të mos hapet përpara dorëzimit”.

Adresa ku do të dërgohet aplikimi i plotësuar nëpërmjet dërgesës postare, ose dorazi jo më vonë se data **29 Mars 2024** ora **14:00**

Adresa e zyrës së Help Shqipëri ku do të dërgohet aplikimi me postë ose dorazi.	Help Shqipëri, Rruga Tish Daija, Kompleksi KIKA 2, Godina 1C9, Hyrja nr.9, Kati i 7-të, Apt.7A 1020 Tiranë, Shqipëri
---	--

Aplikimet e dërguara nëpërmjet çdo mënyre tjetër (p.sh. me faks apo e-mail) apo të dërguara në adresë të tjera do të refuzohen.

Çdo aplikim i dorëzuar apo marrë pas përfundimit të afatit do të refuzohet automatikisht.

Ju lutem bëni një kopje të aplikimit tuaj të plotësuar në mënyrë që një ta mbani për vete dhe një e dërgoni në Help sipas instruksioneve të përmendura më lart. Ky aplikim paraqet dokumentin fillestar në procesin e përzgjedhjes së përfituesit të grantit. Në bazë të të dhënave të përmendura në këtë aplikim, Help përzgjedh në bazë të kriterëve shoqërore dhe ekonomike.

Është e domosdoshme që përgjigjet të jenë sa më të plota dhe të detajuara në të gjitha pyetjet e aplikimit.

Për informacion shtesë, mund të na drejtoheni në adresën elektronike në vijim:

helpinalbania@gmail.com

ose në numrin e telefonit: **069 572 6762** deri me datë **22 Mars 2024**

Aplikimet e plotësuara, së bashku me dokumentacionin e bashkangjitur, nuk i kthehen aplikantit.

IX. PËRZGJEDHJA, KONTRAKTIMI DHE ZBATIMI I PROCEDURËS

Procesi i dhënies së granteve do të zbatohet në një cikël që ndjek hapat e mëposhtëm:

- Shpallja e thirrjes së hapur.**
- Mbajtja e sesioneve informuese** të cilat kanë për qëllim dhënien e sqarimeve për plotësimin e formularit të aplikimit si dhe përgjigjen ndaj pyetjeve dhe paqartësive që aplikantët mund të kenë rreth formës së aplikimit në përgjithësi dhe procesit të dhënies së granteve në veçanti. Këto sesione do të mbahen online, në takime ballë për ballë ose përmes sqarimit me telefon brenda afateve të përcaktuara në kalendarin e njoftimeve për sesione informimi.

3. **Dorëzimi i aplikimeve** në adresën e dhënë brenda afatit të përcaktuar në thirrje. Të gjitha aplikimet e marra përpara përfundimit të afatit për dorëzimin e aplikimeve do të shqyrtohen nga Help.
4. **Ngritja e Komisionit të Vlerësimit dhe Përzgjedhjes së aplikantëve.** Për përzgjedhjen e përfituesve të grantit Help do të krijohet një komision përzgjedhës të përbërë nga punonjës të Help dhe përfaqësues të Bashkisë Tiranë.
5. **Faza e parë e vlerësimit dhe përzgjedhjes së aplikimeve** e cila do të mbështetet në kriteret e paracaktuara sociale dhe ekonomike. Kriteret sociale i referohen statusit social të përfituesve të mundshëm dhe nivelit të cënueshmërisë, vlerësimit të kushteve të jetesës, të ardhurave të disponueshme familjare dhe fakteve të tjera. Kriteret ekonomike përdoren për të vlerësuar idetë e biznesit të aplikantëve. Ata marrin parasysh aftësitë e disponueshme, njohuritë për aktivitetin e propozuar, konkurrencën, kërkesat ligjore për të bërë biznes, justifikimin e pajisjeve të kërkuara, të ardhurat e pritshme, kostot dhe fitimin e të tjera. Në bazë të vlerësimit të të dy kriterëve, do të vlerësohen formularët e parë të aplikimit dhe ata që plotësojnë kriteret do të hyjnë në procesin e dytë të përzgjedhjes.
Renditja e tyre do të bëhet sipas sistemit të pikëzimit të ngritur posaçërisht për këtë skemë bazuar në secilin prej kriterëve sociale dhe ekonomike. Sipas kësaj renditjeje, do të përzgjidhen aplikimet me pikët më të larta, deri në kufirin maksimal të buxhetit të thirrjes. Nëse buxheti nuk është i mjaftueshëm për të financuar dy apo më tepër aplikime, të cilat janë të renditura me pikë të barabarta, granti do t'i jepet aplikimit të dorëzuar më përpara, sipas parimit aplikimi i dorëzuar i pari - përfiton i pari.
Përveç listës së aplikimeve që kalojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në fazën e dytë të përzgjedhjes, do të ketë dhe një listë e aplikimeve në pritje e cila do të shërbejë për t'u marrë në konsideratë në rast se ndonjë prej aplikimeve të dala drejtpërdrejtë nuk e kalon fazën e dytë të përzgjedhjes.
Kujtojmë që nga kjo fazë do të përzgjidhen të paktën 40 aplikime.
6. **Faza e dytë e vlerësimit dhe përzgjedhjes së aplikimeve** e cila konsiston në një intervistë me Zyrtarin e Help dhe synon të kontrollojë dhe konfirmojë informacionin e paraqitur në formularin e parë të aplikimit, si dhe të marrë më shumë detaje mbi idenë e propozuar të biznesit. Kjo intervistë do të zhvillohet në shtëpitë e aplikantëve ose në ambientet e mundshme të biznesit të tyre. Në rast se vërehen se informacionet e dhëna gjatë fazës së parë nga aplikanti janë të pasakta, aplikanti në fjalë do të refuzohet dhe nuk do ta vijojë më tej procesin e përzgjedhjes. Vendin e tij do ta zëre aplikanti i renditur më lart në listën e pritjes, për të cilin do të zhvillohet gjithashtu një fazë e dytë përzgjedhjeje. Një raport mbi këtë fazë do të hartohet dhe do të ndahet me anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Përzgjedhjes me qëllim marrjen e vendimit përfundimtar.

7. **Vlerësimi dhe përzgjedhja e planeve më të mira të biznesit dhe dhënia e granteve.** Në rast se nuk ka kundërshtime nga anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Përzgjedhjes në lidhje me gjetjet e dala nga faza e dytë e përzgjedhjes, një listë përfundimtare e aplikantëve do të shpallet si aplikantët që e kaluan me sukses përzgjedhjen dhe do të njoftohen me shkrim për të kaluar në fazën e nënshkrimit të kontratës së tyre. Në rast se do të ketë kundërshtime, atëherë vendimi përfundimtar do t'i mbetet Komisionit, i cili do të nënshkruajë një raport ku do të jepen hollësi dhe argumenta mbi të cilat bazojnë kundërshtitë e tyre dhe dhënien e vendimit përfundimtar të listës së aplikantëve të suksesshëm.
8. **Kontraktimi dhe përdorimi i fondeve.** Nënshkrimi i kontratës së grantit do të koordinohet nga Help. Kontrata është një marrëveshje mes aplikantëve të përzgjedhur si fitues të grantit dhe Help Shqipëri, e cila rregullon të gjitha detajet, të drejtat dhe detyrimet. Help Shqipëri ka të drejtë të marrë të gjitha makineritë ose pajisjet, në rast se nuk përdoren siç është rënë dakord. Në fund të periudhës së projektit, ato do t'u jepen bizneseve të vogla të suksesshme. Kontratat duhet të nënshkruhen me klientët përfundimtarë jo më vonë se dy javë pas miratimit të listës përfundimtare të klientëve. Ndër të tjera në këtë kontratë do të përcaktohet gjithashtu data dhe numri i llogarisë bankare ku aplikantët e suksesshëm duhet të derdhin shumën e bashkëfinancimit e cila është 20% e vlerës së grantit.
9. **Prokurimi i pajisjeve dhe makinerive.** Blerja e pajisjeve dhe makinerive të kërkuara nga aplikantët e shpallur fitues dhe me të cilët lidhet kontrata e grantit do të kryhet nga Help Shqipëri bazuar në manualin e prokurimeve të Help. Procesi i prokurimit do të zgjasë 3-5 javë nga momenti i nënshkrimit të kontratës.
10. **Dorëzimi i pajisjeve dhe makinerive.** Pas përfundimit të procesit të blerjes së pajisjeve dhe makinerive, do të kryhet procesi i dorëzimit të tyre tek përfituesit e grantit, të cilët do të nënshkruajnë dhe procesverbalin e marrjes në dorëzim të pajisjes apo makinerisë.
11. **Monitorimi dhe vlerësimi.** Qëllimi i monitorimit të përfituesit të grantit është të sigurojë:
 - Informacion në kohë dhe të saktë nëse pajisjet dhe makineritë janë duke u përdorur në përputhje me kontratën e nënshkruar;
 - Monitorimin e suksesit dhe efekteve të pajisjeve dhe makinerive të përfutuara në qëndrueshmërinë dhe zhvillimin e aktivitetit të biznesit të përfituesve të grantit.

Çdo përfitues granti, do të vizitohet çdo muaj për gjashtë muajt e parë, dhe më pas çdo tre muaj deri në fund të periudhës së kontratës dy-vjeçare. Vizitat në terren duhet të organizohen duke (dhe kur nevojitet pa) bërë përcaktimin paraprak të përfituesve, si dhe duke i njoftuar ata një deri në tre ditë para. I gjithë informacioni i mbledhur gjatë vizitave në terren do të reflektohet në një *Formular Standard Monitorimi* që Help disponon. Punonjësit e Help do të diskutojnë dhe marrin vendim për të gjitha vëzhgimet dhe çështjet e identifikuar gjatë vizitave në terren.